



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Lezhë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2022

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

16/05/2022

**Drejtuar:** “DRINI A” SH.P.K, me adrese Lagjja “Nen Tereza”, godina ne rrugen nacionale Lezhe-Shkoder km I-re, ne zonen kadastrale 8632, me nr. pasurie 13/55-1, volum 24, faqe 225, Lezhe.

**Procedura e prokurimit/lotit:** E Hapur e Thjeshtuar/ Mallra.

**Numri i procedurës/ referenca e Lotit:** REF-27099-04-28-2022

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** “Blerje e materialeve per mirembatjen e Rrugeve, Trotuareve dhe Shesheve ne Qytetin e Lezhes”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 12 Muaj nga data e nenshkrimit te Marreveshjes-Kuader.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- Operatori Ekonomik “DRINI A” SH.P.K me Nuis J67902505V, me oferte ekonomike 5,095,280 (pesemilion e nentedhete e pese mije e dyqind e tetedhete) Lek pa TVSH
- Operatori Ekonomik “STELLA” SH.P.K me Nuis J87603505T, me oferte ekonomike 4,395,950 (kater million e treqind e nentedhete e pese mije e nenteqind e pesedhete) Lek pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

### 1. Operatori Ekonomik “STELLA” SH.P.K, Nuis J87603505T,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Nuk ploteson kriterin 2.3.7, ku parashikohet se: “Ditën dhe oren e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Nga 1 (nje) mostër për secilin nga artikujt e mëposhtëm:

*Nga 1 Pllake trotuari betoni per secilën permase.*

- *Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Drejtorise se Sherbimeve Publike, se Bashkise Lezhe me adrese: Rruga “Vellezerit Coku”, Ish SMT, Lezhe.*
- *Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.*
- *Mostrat duhet të jene ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara”,*

pasi Bazuar ne procesverbalin Nr. 01, date 09/05/2022, i mbajtur midis Komisionit te Vleresimit te ofertave dhe Operatoreve Ekonomik te pranishem gjate zhvillimit te procedures per dorezimin e mostrave ditën dhe orën e hapjes se ofertave, Operatori Ekonomik “STELLA” SH.P.K, nuk eshte paraqitur per te dorezuar mostrat per artikujt e kerkuar ne DST.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “STELLA” SH.P.K, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

**Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “STELLA” SH.P.K, skualifikohet.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “DRINI A” SH.P.K, me adrese Lagjja “Nen Tereza”, godina ne rrugen nacionale Lezhe-Shkoder km I-re, ne zonen kadastrale 8632, me nr. pasurie 13/55-1, volum 24, faqe 225, Lezhe, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 5,095,280 (pesemilion e nentedhete e pese mije e dyqind e tetedhete) Lek pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**KRYETARI**  
**Pjerin NDREU**

---